

# Raporti: LIGJI KUNDËR DISKRIMINIMIT NË KOSOVË - Shtatë vite pas

## Përmbledhje

1. Ligji kundër Diskriminimit në Kosovë është miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe është shpallur nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm në vitin 2004. Ai hyri në fuqi më 19 shtator 2004 dhe pa asnjë amandamentim vazhdon të jetë dokument juridik ligjërish i detyrueshëm deri më sot.

2. Në masë të madhe është i bazuar në aktet legislative të Bashkimit Evropian; kryesisht në direktivat për trajtim të barabartë lidhur me racën<sup>1</sup> dhe trajtim të barabartë në punësim dhe profesion<sup>2</sup>.

3. Vetë ligji identifikon një qëllim të trefishtë; së pari të parandalojë dhe luftojë diskriminimin. Së dyti, të promovojë barazinë efektive dhe të vejë në veprim 'parimin e trajtimit të barabartë të qytetarëve të Kosovës para ligjit'<sup>3</sup>. Ngjashmërisht Ligji identifikon edhe parime tjera si trajtimi i barabartë, përfaqësimi i drejtë dhe toleranca ndëretnike<sup>4</sup>.

4. Ndalimi i diskriminimit është vlera themelore mbi të cilën bazohet rendi kushtetues i Kosovës dhe kjo është përfshinë në mbi 25 pjesë të legjislacionit.

5. Megjithatë, pavarësisht masave të gjëra ligjore të vendosura diskriminimi në Kosovë mbetet një fakt i gjallë dhe i cili pranohet se ekziston në masë të gjerë nga qytetarët dhe institucionet.

6. Format e diskriminimit të identifikuar në ligj përfshijnë: diskriminimin e drejtpërdrejtë, diskriminimin e tërthortë, ngacmimin, udhëzimin për të diskriminuar, viktimizimin dhe segregacionin. Këto forma të diskriminimit janë shqyrtuar hollësisht në raport dhe janë mjaft të qarta edhe në ligj. Megjithatë iu kemi referuar jurisprudencës ndërkombëtare për të siguruar shembuj praktik dhe praktikën e mirë kur rastet e tilla janë ngritur në nivel ndërkombëtar, për shkak të mos ekzistencës së tyre në nivel kombëtar.

7. Ligji Kundër Diskriminimit mbulon një gamë impesive prej gjashtëmbëdhjetë bazave të diskriminimit, përfshirë: 'seksin, gjininë, moshën, gjendjen martesore, gjuhën, paaftësinë fizike apo mendore, orientimin seksual, mendimin apo bindjen politike, përkatësinë etnike, kombin, fenë apo besimin, racën, përkatësinë shoqërore, pronën apo statuset tjera'<sup>5</sup>. Është gjithashtu e gjerë në atë që të gjitha bazat më lartë janë të mbrojtura nga diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë<sup>6</sup> dhe lidhur me çdo të drejtë të përcaktuar me ligj<sup>7</sup>, e cila është identifikuar me të drejtë se e tejkalon mbrojtjen e ofruar me Direktivat e Bashkimit Evropian<sup>8</sup>. Prandaj, bazat që mbulohen, me të vërtetë janë shumë gjithëpërfshirëse për të siguruar mbrojtje në një sërë instancash.

<sup>1</sup> Direktiva e Këshillit të Evropës 2000/43/EC

<sup>2</sup> Direktiva e Këshillit të Evropës 2000/78/EC

<sup>3</sup> Neni 1, Ligji Kundër Diskriminimit 2004/3

<sup>4</sup> Neni 2 Po aty

<sup>5</sup> Neni 2 (a) Ligji Kundër Diskriminimit 2004/3

<sup>6</sup> Po aty

<sup>7</sup> Neni 4 (n) Ligji Kundër Diskriminimit 2004/3

<sup>8</sup> Fabian G, 'Implementation of the Anti-Discrimination Law in Kosovo: A plan in need of execution' 31 janar 2006 në dispozicion <http://www.errc.org/cikk.php?cikk=2459> qasur më 21/11/2011

8. Megjithatë, ne kemi shumë pak shembuj praktik në lidhje me pretendimet e diskriminimit mbi këto baza shkak të mungesës së zbatimit të ligjit. Në vend të kësaj iu është referuar situatave ku mund të parashikohet se diskriminimi mbi baza të ndryshme mund të ndodhë. Një bazë të veçantë të diskriminimit, e cila nuk është trajtuar siç duhet nga ana e çdo e institucioni është ajo e orientimit seksual.

9. Duke njohur 'çdo status tjetër', Ligji Kundër Diskriminimit ofron mbrojtje superior në lidhje me baza të reja të diskriminimit dhe zhvillim të mëtejshëm të ligjit.

10. Ligji Kundër Diskriminimit siguron zbatueshmëri të gjerë duke mbrojtur personat fizik dhe juridik nga sektori publik dhe privat. Sa i përket organeve publike, ato mund të mbahen përgjegjëse për çdo veprim apo mos-veprim që shkel një apo më shumë të drejta të një personi apo personave fizik apo juridik<sup>9</sup>. Përveç kësaj, implementimi i fushës së zbatimit të ligjit është i detajuar përmes trembëdhjetë fushave të specifikuar, ndërsa e katërbëdhjeta thekson se implementimi i fushës së zbatimit mund të zgjerohet edhe më tej përmes 'çdo të drejte tjetër të përcaktuar më ligjin në fuqi'<sup>10</sup>.

11. Fushat e zbatueshme janë mjaftueshëm të qarta për tu aplikuar në praktikë brenda procedurave administrative dhe gjyqësore. Përveç kësaj, ekzistojnë mbi 25 pjesë të legjislacionit që ndalojnë diskriminimin në fusha të ndryshme. Megjithatë, edhe një herë zbatimi i tyre mungon dhe krahasimi në mes të mbrojtjes së ofruar në Ligjin Kundër Diskriminimit dhe pjesë të tjera të legjislacionit tregojnë një numër mospërputhjes. Me rëndësi të veçantë është përjashtimi i disa bazave të tilla si orientimit seksual, e cila në fakt përjashton qytetarët nga mbrojtja.

12. Është e rëndësishme, që Ligji njih përjashtime dhe veprime pozitive, të cilat nuk përbëjnë diskriminim. Ato janë mjaft të qarta, por megjithëse shembujt nga Kosova mungojnë, prapë iu kemi referuar jurisprudencës ndërkombëtare

13. Mjetet juridike dhe zbatimi janë aspekte tepër të rëndësishme të ligjit, edhe pse ato nuk janë mjaft të qarta. Veçanërisht, Kreu II i Ligjit i titulluar 'procedura dhe sanksione' paraqet një numër vështirësish në lidhje me zbatimin e tyre. Ndërsa, organet e krijuara për të promovuar trajtimin e barabartë nuk janë krijuar në përputhje me Ligjin

14. Është shumë e qartë se zbatimi i ligjit nuk është në nivel të kënaqshëm. Në vitin 2007 ne gjetëm se kishte një *progres të ngadalshtëm* në zbatim, ndërsa tani hulumtimi ynë tregon se Ligji Kundër Diskriminimit ofron 'mbrojtje vetëm në letër', e cila krijon një mit që ligji mbron të gjithë kundër diskriminimit dhe në praktikë ka" arsye të tjera "për mungesë të efektivitetit.

15. Promovimi i Ligjit Kundër Diskriminimit që nga viti 2004 përgjithësisht ka qenë i paefektshëm për shkak të fushatave të kufizuara, mungesës së koordinimit të institucioneve qeveritare dhe përjashtimi i disa grupeve, sikurse komuniteti LGBT.

16. Informacionet e kërkuara nga institucionet në lidhje me rastet e diskriminimit kanë treguar mungesën e respektimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike nga shumica e

---

<sup>9</sup> Neni 4 Ligji Kundër Diskriminimit

<sup>10</sup> Neni 14 (n) Po aty

institucioneve. Përveç kësaj, shumica e institucioneve nuk kanë pasur raste të tilla dhe ato që kishin pasur, ishin brenda një periudhë të gjatë kohore.

17. Përgjithësisht është identifikuar se vetëm disa raste që kanë të bëjnë me diskriminimin kanë arritur në gjykata, edhe se ato nuk janë trajtuar në mënyrë adekuate.

18. Ngjashëm, Avokati i Popullit ka vetëm disa raste të diskriminimit, prapë brenda një periudhe të gjatë kohore.

19. Mediat jo gjithmonë identifikojnë praktikat diskriminuese në raportimet e tyre dhe nganjëherë diskriminojnë pjesëtarët e grupeve të marginalizuara.

20. Në përgjithësi zbatimi i Ligjit Kundër Diskriminimit në Kosovë nuk ka shënuar ndonjë progres thelbësor. Derisa Ligji është gjithëpërfshirës në përcaktimin e formave të diskriminimit dhe bazave të mbrojtura, Kreu II dhe III nuk janë mjaft të qartë për të mundësuar zbatimin. Këto janë çështje që janë diskutuar me vite, dhe akoma nuk janë bërë përpjekje për t'i adresuar. Sa iu përket organeve të mandatuara për promovimin e trajtimit të barabartë siç është theksuar deri më tani këto janë krijuar përmes Udhëzimeve Administrative në kundërshtim me atë që thotë Ligji Kundër Diskriminimit. Për më tepër, disa grupe të tilla si LGBT janë përjashtuar tërësisht nga mbrojtja, pasi që ata nuk janë përmendur në ndonjë literaturë të prodhuar ose masa pozitive të marra nga institucionet për adresimin e diskriminimit.

21. Lufta kundër diskriminimit do të jetë jo-efektive nëse ekzistojnë Ligje që nuk zbatohen dhe strategjitë janë të shkruara ose trajnimet janë mbajtur. Eliminimi i diskriminimit nuk mund të jetë vetëm çështje *de jure*, në çdo kohë ka nevojë të eliminohet edhe *de facto* dhe institucionet publike janë ligjërisht përgjegjëse të udhëheqin në këtë drejtim.

22. Ne kemi bërë një numër rekomandimesh që institucionet duhet të bashkëpunojnë me të gjitha palët duke përfshirë edhe shoqërinë civile për t'i adresuar..